

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Gjelbërimi në Tiranë



Maj 2024

Përmbajtja

Rreth sondazhit	3
Opinionet mbi shkallën e gjelbërimit dhe njohja me nismat	5
Kujdesi ndaj gjelbërimit dhe përfitimet	8
Frekuentimi i hapësirave të gjelbërta dhe sugjerime	12
Aneks I – Pyetësi i sondazhit	17

Rreth sondazhit

Pozicionimi gjeografik e ka vendosur Tiranën në listën e qyteteve të privilegjuara nga natyra. Ajo ka formën e një amfiteatri të zhytur mes gjelbërimit që formon kurora e malit të Dajtit dhe e kodrave të vendosura në tre anët e tjera. Vetë struktura dhe etapat e ndërtimit të qytetit kanë qenë favorizuese për përçimin e gjelbërimit në brendësi të qytetit, në formën e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara.

Nga pikëpamja sociale, jeta miqësore me mjedisin nxitin një ndjenjë të komunitetit ndërsa individët dhe grupet bashkohen për të zbatuar zgjidhje të ndërgjegjshme për mjedisin. Iniciativat dhe projektet mjedisore të përqëndruara në qëndrueshmëri mund të forcojnë krijojnë një përgjegjësi të përbashkët për mirëqenien e mjedisit tonë.

Bashkia e Tiranës po vijon me nismat dhe aksionet për shtimin e gjelbërimit në qytet, ndërsa ka pasur edhe periudha mobilizimi masiv për mbjelljen e pemëve. Afrimi i qytetarëve dhe subjekteve me nismën “Dhuro pemë për Tiranën” ishte një mundësi e mirë për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra të Tiranës por edhe për promovimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.

Qëllimi i sondazhit: Ky sondazh ka për qëllim të evidentojë opinionet për gjelbërimin në Tiranë, nismat për përmirësimin e hapësirave të gjelbërta dhe përfitimet për komunitetin, si edhe kulturën dhe kujdesin qytetar për mjedisin.

Objektivat:


- a) Të evidentohet sa të gjelbëruar e konsiderojnë qytetarët Tiranën, si edhe opinionet dhe pritshmëritë për nismat dhe fushatat gjelbëruese;
- b) Të identifikohet nëse qytetarët konsiderojnë përfshirjen në nismat gjelbëruese dhe sa të kujdesshëm janë për mirëmbajtjen e gjelbërimit;
- c) Të evidentohet frekuentimi dhe vlerësimi për hapësirat e gjelbërta, si dhe përfitimet për komunitetin;
- d) Të identifikohen zona të mundshme në të cilat qytetarët sugjerojnë mbjellje pemësh ose krijimin e hapësirave të gjelbërta;
- e) Sugjerime për përmirësimin e gjelbërimit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **prill 2024** dhe u plotësuan **700** pyetësorë¹ nga anketimi **ballë për ballë**. Intervistat u realizuan me qytetarë rastësorë në 11 njësitë administrative urbane dhe 3 lagjet.



¹Aneks I – Pyetësi i sondazhit

Demografia

Në total janë anketuar 700 qytetarë rastësorë në 11 njësitë urbane dhe 3 lagjet, me nga 50 pyetësorë për njësi (*Grafiku 1*).



Nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të anketuar **52%** janë meshkuj dhe 48% femra (*Grafiku 2*), **32%** janë të grup – moshës 51-65 vjeç, 29% 36-50 vjeç, 19% 18-35 vjeç etj. (*Grafiku 3*).



Opinionet mbi gjelbërimin dhe njohja me nismat

Perceptimi i qytetarëve për shkallën e gjelbërimit në Tiranë është vlerësuar me **5.9 pikë**, në një vlerësim të shkallëzuar nga 1 në 10, ku 1 tregon aspak e gjelbëruar dhe 10 tregon shumë e gjelbëruar, përkatësisht:


22% kanë vlerësuar me **6 pikë** gjelbërimin në Tiranë;

19% kanë vlerësuar me 7 pikë;


14% kanë vlerësuar me 5 pikë;

12% kanë vlerësuar me 8 pikë;


8% kanë vlerësuar me 4 pikë etj. (Grafiku 4).




Për nismat dhe fushatat e Bashkisë Tiranë lidhur me gjelbërimin, rekreacionin dhe mbjelljen e pemëve si p.sh. Dhuro pemë për Tiranën, pyllëzimi i parqeve dhe ndërtimi i xhepave të gjelbër, **64%** e të anketuarve janë përgjigjur se janë në dijeni të këtyre nismave, 21% janë shprehur se nuk janë në dijeni, ndërsa 15% nuk kanë dhënë një përgjigje (Grafiku 5).



Të pyetur nëse kanë konstatuar përmirësim të gjelbërimit në qytet, si rezultat i mbjelljes së pemëve apo mirëmbajtjes, **43%** janë përgjigjur “Pjesërisht”, 25% “Jo”, 20% “Po”, ndërsa 12% nuk kanë dhënë një përgjigje (Grafiku 6).




Sipas qytetarëve të anketuar, faktorët që pengojnë gjelbërimin në Tiranë janë: urbanizimi i pakontrolluar **54%**, mungesa e hapësirës në qytet dhe mungesa e ndërgjegjësimit përkatësisht **35%**, ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional përkatësisht **32%**, mungesa e financimit dhe burimeve **17%** (Grafiku 7).




Kujdesi ndaj gjelbërimit dhe përfitimet


Të pyetur se *si mund të përmirësohet infrastruktura gjelbëruese në qytet*, **54%** mendojnë nëpërmjet zhvillimit të parqeve dhe hapësirave të gjelbra, përkatësisht 35% janë shprehur për programe për komunitetin për mbjelljen e pemëve dhe promovimin e bimëve të gjelbra në troturare, biznese etj., përkatësisht 33% duke përmirësuar pyjet ekzistuese dhe duke instaluar tarraca dhe mure të gjelbërta, ndërsa 26% duke mbikqyrur dhe mirëmbajtur zonat e gjelbëruara (*Grafiku 8*).




Në opinionin e qytetarëve *përfitimet që mund të sjellë një qytet më i gjelbëruar* janë: përmirësimi i cilësisë së ajrit **65%**, ulja e ndotjes së mjedisit 49%, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies 47%, zbukurimi i qytetit 43%, rritja e mundësive për të pushuar 35% dhe reduktimi i zhurmave 17% (Grafiku 9).



44% e të anketuarve janë shprehur se ndoshta *do të përfshiheshin në nismat për mbjelljen e pemëve* por kanë nevojë për më shumë informacion, 32% nuk janë të interesuar të përfshihen, 15% janë plotësisht të interesuar, ndërsa 9% nuk kanë dhënë një përgjigje (*Grafiku 10*).




Lidhur me kujdesin qytetar për mirëmbajtjen e gjelbërimit, **41%** janë përgjigjur se qytetarët janë disi të kujdesshëm, **27%** mendojnë se nuk janë të kujdesshëm, **18%** mendojnë se janë të kujdesshëm, ndërsa **14%** nuk kanë dhënë një përgjigje (*Grafiku 11*).




Frekuentimi i hapësirave të gjelbërta dhe sugjerime

33% e të anketuarve janë përgjigjur se i *frekuentojnë hapësirat e gjelbërta* disa herë në muaj, 19% ndonjëherë, 18% disa herë në javë, 11% një herë në muaj, 10% çdo ditë dhe po 10% disa herë në vit (Grafiku 12).



49% e qytetarëve të anketuar mendojnë se *gjatë 4 viteve të fundit hapësirat e gjelbërta në Tiranë* janë përmirësuar, **27%** mendojnë se nuk kanë ndryshuar, **11%** mendojnë se janë përmirësuar shumë, **6%** mendojnë se janë përkeqësuar etj. (Grafiku 13).



Sugjerime

Për secilën njësi administrative banorët përkatës kanë sugjeruar *zona të mundshme për mbjelljen e pemëve apo ku mund të krijohen hapësira dhe xhepa të gjelbër:*

Njësia Administrative Nr.1

Rr. Idriz Dollaku	9 sugjerime
Rr. Mustafa Greblleshi	4 sugjerime
Rr. Dhimër Kamarda	3 sugjerime
Rr. Luleve	2 sugjerime
Rr. Zonja Çure	2 sugjerime
Rr. Asdreni	2 sugjerime
Sheshi “Taulantia”	2 sugjerime

Njësia Administrative Nr.2

Rr. Çollakëve	3 sugjerime
Rr. 3 Vellezërit Kondi	3 sugjerime
Rr. Gramoz Pashko	3 sugjerime
Rr. Arben Broci	3 sugjerime
Rr. Shyqyri Ishmi	2 sugjerime
Blv. Bajram Curri	2 sugjerime
Sheshi “Taulantia”	2 sugjerime
Rr. Budi	2 sugjerime

Njësia Administrative Nr.3

Rr. Kongresi i Manastirit	10 sugjerime
Rr. Arben Minga	6 sugjerime
Rr. Kujtim Laro	6 sugjerime

Njësia Administrative Nr.4

Rr. Aleksandër Moisiu	3 sugjerime
-----------------------	-------------

Njësia Administrative Nr.5

Sheshi “Wilson”	4 sugjerime
Rr. Ymer Kurti	2 sugjerime
Rr. Pjetër Bogdani	2 sugjerime
Rr. Sulejman Delvina	2 sugjerime

Njësia Administrative Nr.6

Rr. Ali Kelmendi	6 sugjerime
Rr. Thoma Goxhaj	3 sugjerime
Rr. Fabrika e qelqit	3 sugjerime
Sheshi “Garibaldi”	2 sugjerime

Njësia Administrative Nr.7

Rr. Frosina Plaku	7 sugjerime
Rr. Artan Lenja	5 sugjerime
Rr. Him Kolli	4 sugjerime
Rr. Frederik Shiroka	3 sugjerime
Kryqëzimi 21 Dhjetori	2 sugjerime
Rr. Dëshmorët e Fekenit	2 sugjerime
Rr. Kongresi Lushnjës	2 sugjerime
Rr. Sulejman Pitarka	2 sugjerime
Rr. Vangjush Furxhi	2 sugjerime
Rr. Xhezmi Delli	2 sugjerime
Rr. Nikolla Lena	2 sugjerime

Njësia Administrative Nr.8

Rr. 5 Maji	6 sugjerime
------------	-------------

Njësia Administrative Nr. 9

Rr. Dervish Hatixhe	4 sugjerime
Bulevardi i Ri	3 sugjerime
Rr. Maliq Muço	3 sugjerime
Rr. Kongresi Tiranës	3 sugjerime

Njësia Administrative Nr.10

Rr. Kajo Karafili	5 sugjerime
Rr. Reshit Çollaku	4 sugjerime
Rr. Durrësit	3 sugjerime
Rr. Bogdani	2 sugjerime

Njësia Administrative Nr.11

Rr. Gjergj Legisi	6 sugjerime
Sheshi “Shqiponja”	4 sugjerime
Rr. Lord Bajron	4 sugjerime
Rr. Azem Galica	3 sugjerime
Rr. Mërgimtari	2 sugjerime

Lagjia Nr.12

Rr. Muhamet Deliu 2 sugjerime

Lagjia Nr.13

Rr. Ernesto Telini 3 sugjerime

Rr. Peti 2 sugjerime

Rr.Thimi Kroi 2 sugjerime

Rr. Nevruz Pashko 2 sugjerime

Rr. Hamide Bozdo 2 sugjerime

Shëtitortja “Lasgush Poradeci”2 sugjerime

Lagjia Nr.14

Rr. Teodor Keko 4 sugjerime

Bulevardi Migjeni 3 sugjerime

Rr. Zografët 2 sugjerime

Rr. Loni Ligori 2 sugjerime

Sugjerime për promovimin e gjelbërimit dhe mbrojtjen e mjedisit:

Të mbillen më shumë pemë nëpër lagje 9 sugjerime

Të rritet ndërgjegjësimi në shkolla 9 sugjerime

Të ketë kalendar për mbjelljen e pemëve 3 sugjerime

Aneks I – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. pyetësi _____

Data e intervistës: _____/_____/2024

PYETËSOR

“GJELBËRIMI NË TIRANË”

Nj. Administrative/Lagje	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)				
	F	M	Nën 18	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

1. Cili është perceptimi juaj për shkallën e gjelbërimit në qytetin e Tiranës?

Aspak e gjelbëruar – 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 – Shumë e gjelbëruar

2. Jeni në dijeni të nismave/fushatave të Bashkisë së Tiranës lidhur me gjelbërimin, rekreacionin dhe mbjelljen e pemëve?

(Dhuro pemë për Tiranën; Pyllëzimi i Parkut të Liqenit Artificial; Liqenit të Farkës, Kasharit, Vaqarrit; Pylli orbital; Ndërtimi i xhepave të gjelbër etj.)

Po Jo Pa përgjigje

3. A keni konstatuar përmirësim të gjelbërimit në zonën/njësine tuaj të banimit si rezultat i mbjelljeve të pemëve dhe mirëmbajtjes?

Po
 Pjesërisht
 Jo
 Nuk e di

4. Cilët janë faktorët që mendoni se pengojnë gjelbërimin në qytetin tonë?

(Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

Mungesa e hapësirës në qytet
 Urbanizimi i pakontrolluar
 Ndikimi i ndryshimeve klimatike
 Mungesa e financimit dhe burimeve për gjelbërimin
 Mungesa e ndërgjegjësimit dhe edukimit
 Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional

Tjetër: _____

5. Si mendoni se mund të përmirësohet infrastruktura gjelbëruese ne qytetin e Tiranës? *(Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)*

- Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të gjelbra
- Përmirësimi i pyjeve ekzistuese në qytet
- Instalimi i terracave dhe mureve të gjelbërta (bimësia vertikale)
- Promovimi i bimëve të gjelbra në trotuare, biznese etj.
- Programe për komunitetin për mbjelljen e pemëve
- Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e zonave të gjelbëruara

Tjetër: _____

6. Cilat janë përfitimet që mendoni se mund të sjellë një qytet më të gjelbëruar për banorët dhe mjedisin në përgjithësi?

(Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- Uljen e ndotjes së mjedisit
- Përmirësimin e cilësisë së ajrit
- Përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies
- Zbukurimin e qytetit
- Rrit mundësitë për të pushuar
- Reduktimin e zhurmave

Tjetër: _____

7. A do të bëheshit pjesë e nismave për mbjelljen e pemëve, apo të tregoni kujdes për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta në qytet?

- Po, do të isha e/i interesuar
- Ndoshta, por më duhet më shumë informacion si të përfshihem
- Jo, nuk jam e/i interesuar
- Pa përgjigje

8. Në opinionin tuaj, sa të kujdesshëm dhe të ndërgjegjësuar janë qytetarët në përgjithësi për mirëmbajtjen e gjelbërimit?

- Të kujdesshëm
- Disi të kujdesshëm
- Nuk janë të kujdesshëm
- Nuk e di

9. Sa shpesh i frekuentoni hapësirat e gjelbërta në qytet?

(Parqet, miniparqet, lulishtet, hapësirat e gjelbërta në qytet etj.)

- Çdo ditë
- Disa herë në javë
- Disa herë në muaj
- Një herë në muaj
- Disa herë në vit
- Ndonjëherë

10. Si janë zhvilluar hapësirat e gjelbërta në Tiranë gjatë 4 viteve të fundit?

(Parku i Madh i Liqenit Artificial, Parku Botanik dhe Zoologjik, Parku Rinia, Parku i Liqenit të Farkës etj.)

- | | |
|--------------------------|--------------------|
| <input type="checkbox"/> | Përmirësuar shumë |
| <input type="checkbox"/> | Përmirësuar |
| <input type="checkbox"/> | Nuk kanë ndryshuar |
| <input type="checkbox"/> | Përkeqësuar |
| <input type="checkbox"/> | Përkeqësuar shumë |
| <input type="checkbox"/> | Nuk e di |

11. Specifikoni një apo më shumë zona ku mund të mbillen pemë apo të krijohen hapësira të gjelbërta, xhepa të gjelbër etj:

12. A keni sugjerime për aktivitete dhe projekte të reja për të promovuar gjelbërimin dhe mbrojtjen e mjedisit në Tiranë?

Shënim: Ky sondazh organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet për gjelbërimin në Tiranë, nismat për përmirësimin e hapësirave të gjelbërta dhe përfitimet për komunitetin, si edhe kulturën dhe kujdesin qytetar për mjedisin. Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin Nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.